



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Korçë, më 15.06.2022

VENDIM

Nr. 09 datë 15/06/2022

“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
 - Spanja Theodorika Pipa, lindur në Korçë më 24.01.1938
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

Konceptoi: Gjergji Kristo
Sekretari i Këshillit të Qarkut: Bashkim Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për Përfitim të pensionit të posaçëm shtetëror

Për Znj. Spanja Pipa

Në datën 01.06.2022, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa e znj. Spanja Pipa për ti propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore.

Nga dokumentacioni që i ka bashkëlidhur kërkesës rrezulton se kërkuësja i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Date 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

Znj. Spanja Theodorika Pipa është lindur më 24.01.1938 në Korçë, e ndikuar nga babai i saj si një prej përfaqësuesëve të parë të serenatës korçare ajo është aktivizuar që në moshë të vogël ku paraqitjen e parë e ka pasur në vitin 1954 në shfaqjen e mjeshtrit Pavlo Sholla. Bashkëpunimet e para i ka realizuar me Lefkothe Kanen, Dhimitra Melen, Luiza Skramin, Geri Kamenicën, Ilo Evron, Keti Cicon, Mihallaq Zallëmin etj. Në vitin 1958 bëhet pjesë e estradës së ushtarit, ndërsa me mbarimin e shkollës pedagogjike dhe krijimin e Estradës profesioniste të Korçës, më 1960 emërohet “Artiste profesioniste”. Nën drejtimin e regjizorëve të mëdhenj si Sokrat Mio, Piro Mani, Aleko Skali, Dhimitër Orgocka ka spikatur në këngë, monolog, parodi ku dhe ka interpretuar me artistë si Aleko Prodanin, Dhimitra Mele, Dhimitër Pema, Niko Qirici, Ali Dhoga, Jani Andrea etj. Ka spikatur tek shfaqja e Shekspirit “Nata e dymbëdhjetë” e vënë në skenë nga regjisori Piro Mani me rolin e Marisë. Një suksese të madh ka arritur tek dramat “Nusja moderne”, “Ishulli i Afërditës”, por mbi të gjitha tek “Era e lartësive” e Namik Dokles në rolin e Erës. Ka sjellë një sërë këngësh të serenatës ke kolegët si Abaz Hajro, Aleko Skali, Aleko Prodanin, Dhimitra Melen, Nusret Frashërin, Guri Napolonin, Gaqo Priftin e të tjerë por që nuk gëzuan sukses pasi u konsideruan si të papërshtatshme për shoqërinë e kohës. Del në pension në moshën 45 vjeçare në

vitin 1984, ku edhe shkëputet nga skena por jo nga kënga, ku ka vijuar të këndojë serenatën korçare pas viteve 90” e deri më sot. Një rëndëi të veçantë ka zënë edhe botimi i librit monografik mbi jetën artistike i cili është prezantuar me sukses dhe është shoqëruar edhe me një CD me regjistrime origjinale. Në vitin 2021 është nderuar me çmimin e parë në duetin “Ti ma more zemrën” me Devis Xherhun si klipi më i mirë i Festivalit të klipit shqiptar organizuar në Ulqin.

Gjatë karrierës së gjatë është vlerësuar me shumë urdhëra, çmime, medalje e tituj, ndër të cilët mund të përmendim:

- “Çertifikatë Mirënjohjeje”, Fondacioni “E shkuara për të ardhmen”, vitin 2002
- “Çertifikatë Mirënjohjeje”, Me rastin e 60-vjetorit të krijimit të Pallatit të Kulturës, Bashkia Korçë, Korçë .
- Titulli “Emblema e Artë”, Bashkia Korçë dhe Këshilli bashkiak. 2610.2010
- Titulli “Mjeshtër i Madh”, Tiranë 20.01.2022

Znj. Spanja Pipa i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 ”Për sigurimet shoqërore ne Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe çertifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;
- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 ”Per kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

Konc. Gj. Kristo

